- Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatorësh, operatori ekonomik ofertues, krahas dokumentacionit të sipërcituar për secilin rast respektivisht, duhet të paraqesë edhe Kontratën e bashkimit të operatorëve shoqëruar me tabelën e ndarjes së punimeve, ku të cilësohen punimet që ka marrë përsipër të kryejë secili anëtar i BOE.
- Për kontratat e realizuara si Nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën baze ndërmjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor, si dhe miratimin zyrtar si nënkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në rrugë elektronike rezulton se Operatori Ekonomik **Shoqëria IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.P.C) shpk** me **NIPT L91310511L**, i cili sipas marrëveshjes së bashkëpunimit ka marrë përsipër të kryejë 29% të punimeve nuk plotëson përvojën për punë të ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes në bashkim sipas kriterit për kualifikim.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Adresa : Lgj.18 Tetori, Rr. Vath Korreshi, pranë ish-parkut të mallrave

E-mail : kontakt@ukl.al :

[NIPT : M24606401K](#)

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik **Shoqëria LIQENI VII shpk** me NIPT K01730502W & **Shoqëria A.K.M** me NIPT L22301501A & **Shoqëria IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.P.C)** shpk me NIPT L91310511L, nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Pika 2.3.2, germa c) **Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:**

- ✓ **Tuba Ujësjiellësi PE 100 RC**
- ✓ **Rakorderi Ujësjiellësi**
- ✓ **Mates uji**
- ✓ **Elektropompa centrifugale**
- ✓ **F.V Panele fotovoltaike**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
- Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë **çertifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi** që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Nga verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në rrugë elektronike rezulton se BOE nuk ka paraqitur Autorizimin e prodhuesit, Katalogun, çertifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-

2015 dhe ISO 14001-2015, për paisjen “F.V Panele fotovoltaike”, sipas kriterit për kualifikim.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumenatcionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i skualifikuar.

Sa më lart, referuar nenit 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor **bëri s`kualifikimin e** Bashkimit të Operatorëve Ekonomik **Shoqëria LIQENI VII me NIPT K01730502W & Shoqëria A.K.M me NIPT L22301501A & Shoqëria IDEAL CONSTRUCTION AND PROJECTION (I.P.C) shpk me NIPT L91310511L.**

4. Operatori Ekonomik **Shoqëria “ GRAND KONSTRUKSION M” shpk me NIPT L38109801T** me adresë: Ballsh, Mallakastër, me vlerë të ofruar 398,400,676 (treqind e nëntëdhjetë e tetë million e katërqind mijë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e gjashtë) lek pa TVSH

S`Kualifikohet

Arsyet:

Operatori Ekonomik **Shoqëria “ GRAND KONSTRUKSION M” shpk** nuk plotëson Kriteret e Përgjithshme për Kualifikim, pasi nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojces 8.

Operatori Ekonomik **Shoqëria “ GRAND KONSTRUKSION M” shpk** nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Pika 1, pasi nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se nuk ka paraqitur Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Operatori Ekonomik **Shoqëria “ GRAND KONSTRUKSION M” shpk** nuk plotëson Kriteret e Veçanta për Kualifikim, Pika 2, pasi nga dokumentacioni i dorëzuar rezulton se nuk ka paraqitur:

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të certifikuara të bilanceve të tre viteve të fundit **2022, 2023, 2024** të konfirmuara me vulë pranë administratës tatimore. Operatorët Ekonomikë të cilët plotësojnë 2 nga 3 kërkesat e gjurmës “c” të nenit 41 të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor,

organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” të ndryshuar; krahas bilanceve të paraqesin dhe raportet e audituesit të pavarur (Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar) për bilancet e këtyre viteve të konfirmuara nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit.

2.2.2. Kopje të deklaratave të xhiros vjetore, të realizuar nga Operatori Ekonomik ofertues gjatë 3 (tre) viteve të fundit **2022, 2023, 2024** lëshuar nga Administrata Tatimore, ku xhiro mesatare e këtyre tre viteve të jetë me vlerë jo më të vogël se vlera e fondit limit të kontratës që prokurohet.

Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare do të konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ky kriter plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen dhe/ose kushtet e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

2.2.3. Operatori Ekonomik duhet të paraqesë vertetim nga organet e pushtetit lokal (Komuna / Bashkia) për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2024 (për NIPT-in kryesor dhe për NIPT-et sekondare), ku të përfshihet kësti për periudhën përkatëse të maturuar (**të vitit 2025**) sipas përcaktimeve të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar në të gjitha vendet ku ushtron aktivitetin sipas Rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Bashkia ose Komuna në të cilën është regjistruar sipas QKB-se.

**** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Përvojë të suksesshme në realizimin e të paktën:

- c. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Ose

- d. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku e realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërës prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.2 Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

- a) Operatori Ekonomik duhet të dëshmojë se disponon liçensë profesionale për zbatim punimesh në ndërtim, duke përfshirë kategoritë e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë kriter, duhet të paraqesë liçensën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr.42 datë 16.01.2008 “Për Miratimin e Rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të Subjekteve Juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë profesionale të shoqërisë, të vlefshme, për kategoritë e mëposhtme:

- | | |
|--|----------------------|
| • Kategoria NP- 1 Punime gjërmimi në tokë | Klasifikimi |
| C | |
| • Kategoria NP- 2 Ndërtime Civile dhe Industriale | Klasifikimi |
| A | |
| • Kategoria NP- 7 Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje | Klasifikimi F |
| • Kategoria NP 11 Ndërtime për n/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë | Klasifikimi A |
| • Kategoria NP-12 Punime të inxhinierisë së mjedisit | Klasifikimi |
| A | |
| • Kategoria NS-18 Punime topogjeodezike | Klasifikimi |
| B | |
| • Kategoria NS-20 Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë | Klasifikimi |
| A | |

b) Çertifikatat që duhet të paraqesin Operatorët Ekonomikë:

- Certifikatë ISO 9001 - 2015 “Për Sistemin e menaxhimit të cilësisë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë ISO 14001-2015 “Për Sistemin e menaxhimit të mjedisit”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.
- Certifikatë ISO 45001-2018 “Për Sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurimit në punë”, objekti i së cilës të jetë në përputhje me objektin e prokurimit.

c) Në përputhje me kërkesat dhe përmasat e publikuara nga Autoriteti Kontraktor në specifikimet teknike dhe preventiv, për listën e artikujve, si më poshtë:

- ✓ **Tuba Ujësjiellësi PE 100 RC**
- ✓ **Rakorderi Ujësjiellësi**
- ✓ **Mates uji**
- ✓ **Elektropompa centrifugale**
- ✓ **F.V Panele fotovoltaike**

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë:

- Autorizim të Prodhuesit / ve ose autorizim nga Distributori i autorizuar prej Prodhuesit ose Marrëveshje bashkëpunimi të zyrtarizuar, e cila të tregojë lidhjen midis ofertuesit dhe prodhuesit ose midis ofertues-distributor-prodhues për listën e mësipërme të mallrave. Autorizimi / Marrëveshja e bashkëpunimit duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: Telefon, fax, e-mail, ëbsite, e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij, si dhe të jetë e vlefshme deri në realizimin e plotë të punimeve. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer dhe i noterizuar në gjuhën zyrtare shqipe.
- Katalogun / et ose fragmente të katalogut/eve të prodhuesit / ve për listën e mësipërme të artikujve në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Shënim: Fragmentet e Katalogut / ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.
- Operatori Ekonomik për të gjitha materialet e mësipërme duhet të paraqesë **çertifikatë / vetëdeklarim nga Prodhuesi** që deklaron se sistemi i menaxhimit të cilësisë të prodhuesit/ve është sipas standartit ISO 9001-2015 dhe ISO 14001-2015. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën për verifikimin e vetëdeklarimit gjatë procesit të vlerësimit të dokumentacionit.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas artikujve që do të marrë përsipër të furnizojë referuar preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

Shënim: Të gjitha normat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të publikuara nga Autoriteti Kontraktor, do t'i referohen edhe ekuivalenteve të tyre, standarteve shqiptare SSH të miratuara nga Drejtoria e Përgjithshme e Standartizimit DPS, në ato raste kur këto standarte janë unifikuar nga kjo Drejtori.

e) Për matësat e ujit

- Operatori Ekonomik të paraqesë certifikatë ose deklaratë nga prodhuesi / distributori i autorizuar që vërteton se standarti i prodhimit të matesave të ujit është sipas OIML R49 / ekuivalente me të, sipas rekomandimeve të Organizatës Internacionale të Metrologjisë Ligjore.

- Operatori Ekonomik të paraqese certifikaten e aprovimit sipas MID /ekuivalente me të, sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9875 datë 14.02.2008 ndryshuar me Ligjin Nr. 10217 datë 21.01.2010, Ligjin Nr. 14/2013 dhe Ligjin Nr. 100/2015.

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë stafin kryesor e mbështetës, punonjësit specialistë dhe certifikimet përkatëse, si më poshtë:

- a) Operatori Ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë punësuar mesatarisht të paktën **80 (tetëdhjetë)** punonjës për periudhën e 3 (tre) muajve të fundit duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit. Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë disponimin e numrit minimal të punonjësve për periudhën e mesiperme në Formularin përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës Nr. 8 *“Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”*.
- b) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë** të cilët të figurojnë në listëpagesa për të paktën 3 (tre) muajt e fundit, nga data e hapjes së tenderit, si më poshtë:

- | | |
|--------------------------------|---------|
| • Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| • Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| • Inxhinier Gjeodet / Topograf | 1 (një) |
| • Inxhinier Gjeolog | 1 (një) |

- c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe **stafin tjetër inxhinierik** (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- | | |
|-------------------------|---------|
| • Inxhinier Ndërtimi | 1 (një) |
| • Inxhinier Hidroteknik | 1 (një) |
| • Inxhinier Elektrik | 1 (një) |

❖ ***Stafi i kërkuar në pikën 2.3.3 pika c, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruara në procedura të shpallura fituese.***

- d) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005“Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një **deklarate** (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), **Drejtuesin Teknik të punimeve** (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërisë dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin

Publik” të ndryshuar.

e) Operatori ekonomik pjesëmarrës, duhet të ketë të punësuar stafin teknik të përbërë nga të paktën **20 (njëzet)** punonjës të specializuar dhe të certifikuar sipas profesionit që kryejnë dhe të pasqyruar në listë pagesat e shoqërisë për periudhën 3 muajt e fundit, duke marrë si referencë datën e hapjes së tenderit, me profesione si më poshtë:

- 2 (dy) teknike ndertimi
- 4 (katër) hidraulike
- 3 (tre) specialiste karpentier
- 2 (dy) mekanik
- 3 (tre) montator
- 1 (nje) saldatore
- 1 (nje) hekurkthyes
- 1 (nje) hidroizolues
- 1 (nje) elektrikist
- 2 (dy) shofere për drejtim mjetesh të pajisur me leje drejtimi me kategorine "C" dhe/ose "CE" dhe/ose "D" dhe/ose "DE" leshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor.

f) Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të paktën:

- **2 (dy)** Manovratorë / Eskavatoristë / Automakinist, të cilët mund të jenë pjesë e stafit ose të kontraktuar me kontratë pune / shërbimi, për realizimin e objektit të prokurimit me afat deri në përfundimin e kontratës.

g) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar si staf mbështetës, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplome (në rast se është inxhinier), dëshmi / certifikatë trajnimi të lëshuara nga subjekte të akredituar sipas ligjit, si dhe të figurojë në listepagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit nga data e hapjes së tenderit, punonjësit si më poshtë:

- 1 (një) punonjës të certifikuar me dëshmi trajnimi si “Person i ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë” të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, kërkesë kjo në përputhje me kërkesat e Ligjit Nr.10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”. Në rastin e bashkimit të Operatorëve Ekonomikë, sipas nenit 88 të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 të ndryshuar, secili prej operatorëve ekonomike duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1(një) “Person të ngarkuar përgjegjës për sigurinë dhe shëndetin në punë”, sipas zërave të

punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkëpunimit.

- 1 (një) specialist Ekspert Zjarifikës në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin, në mbështetje të pikës 4 të nenit 49 të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin”, të pajisur me certifikatë të lëshuar nga Drejtoria e MZSH.

h) Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar mjekun e shoqërise ose mjek të kontraktuar nga jashtë me kontratë shërbimi / me subjekte të specializuara për këtë qëllim. Mjekët të jenë të pajisur me licencë profesionale nga Ministria e Shëndetësisë. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili prej anëtarëve të bashkimit që plotëson kriteret e VKM Nr.742 datë 06.11.2003, duhet të plotësojë këtë kërkesë, sipas zërave të punimeve/shërbimeve/mallit që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes se bashkëpunimit.

2.3.4. Operatori Ekonomik duhet të jetë i pajisur me Licencë të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë dokumentat e mësipërme sipas preventivit të objektit të prokurimit dhe kontratës së bashkëpunimit të nënshkruar.

2.3.5. Makineri Pajisje

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë makineri dhe pajisje sipas tabelës së mëposhtme, të cilat **duhet të jenë në pronësi të tij ose me qera**, të vërtetuara këto me dokumentacionin përkatës:

Nr.	Përshkrimi	Sasia
9.	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton</i>	<i>1 (nje) cope</i>
10.	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 10 - 18 ton</i>	<i>1 (një) cope</i>
11.	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes 5 - 10 ton</i>	<i>2 (dy) cope</i>
12.	<i>Kamionçina me kapacitet mbajtes deri në 3.5 ton</i>	<i>2 (dy) cope</i>
13.	<i>Rimorkiator per transportin e makinerive</i>	<i>1 (nje) cope</i>
14.	<i>Eskavator me zinxhire</i>	<i>1 (nje)cope</i>
15.	<i>Eskavator me goma</i>	<i>1 (nje) cope</i>
16.	<i>Fadrome me goma</i>	<i>1 (nje)cope</i>

17.	<i>Minieskavator / minifadrome</i>	<i>1 (nje)cope</i>
18.	<i>Çekic Pneumatik</i>	<i>1 (nje) cope</i>
19.	<i>Autobetoniere</i>	<i>1 (nje) cope</i>
20.	<i>Betoniere të vogla</i>	<i>2 (dy) cope</i>
21.	<i>Vibrator Betoni</i>	<i>1 (nje)cope</i>
22.	<i>Autobot uji</i>	<i>1 (nje) cope</i>
23.	<i>Matrapik</i>	<i>1(nje)cope</i>
24.	<i>Pajisje për matjen e presionit</i>	<i>1 (nje) cope</i>
25.	<i>Sonde shpimi</i>	<i>1 (nje) cope</i>
26.	<i>Gjenerator</i>	<i>2 (dy) cope</i>
27.	<i>Depozita uji</i>	<i>1 (nje) cope</i>
28.	<i>Tokmak</i>	<i>1 (dy) cope</i>
29.	<i>Aparaturë për bashkim tubacionesh</i>	<i>2 (dy) cope</i>
30.	<i>Aparat për saldimin e tubove</i>	<i>1 (nje)cope</i>
31.	<i>Manometer</i>	<i>1 (nje) cope</i>
32.	<i>Saldatrice elektrike</i>	<i>1 (nje) cope</i>
33.	<i>Tranxhe hekuri/kthyesë hekuri</i>	<i>1 (nje) cope</i>

Mjete dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit në zbatim të kërkesave të VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e Rregullores për sigurinë në kantier”, si më poshtë vijon:

- Kokore + Jelekë fosforoshentë minimumi 50 copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 4 copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 5 copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 10 copë

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe të pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruara në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës deklarë se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

2.3.6. Afati i kryerjes së punimeve

Operatori Ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve në përputhje me afatin kohor që është lënë në dispozicion për realizimin e kontratës.

Operatori Ekonomik Ofertues duhet të paraqesë deklaratën **ku të shprehet se është dakort me menyrën e financimit të objektit dhe se punimet për realizimin e këtij objekti do të perfundojnë brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktor, (Në rast të shpalljes fitues).** Paraqitja e kësaj deklarate është kërkuar pasi burimi i financimit për këtë procedurë është Buxheti i Shtetit, e përcaktuar edhe tek Pika 2.10 e DST-së.

Sa më lart, referuar nenit 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024, ku parashikohet: “*Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji*”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor **bëri s`kualifikimin e Operatorit Ekonomik Shoqëria “ GRAND KONSTRUKSION M” shpk me NIPT L38109801T**

5. Operatori Ekonomik **BE - IS SH.P.K** me **NIPT K71412003A** me adresë: Godina Nr.2, Heci Veleshice, Kalis, Zall Kalis, Kukes, me vlerë të ofruar 421,836,123 (katërqind e njëzet e një million e tetëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e njëqind e njëzet e tre) lekë pa TVSH

S’Kualifikohet

Arsyet:

Operatori Ekonomik **BE - IS SH.P.K** me **NIPT K71412003A** nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Pika 2.3.3, germa c) Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin tjetër inxhinierik (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)
- Inxhinier Elektrik 1 (një)

Për stafin e mësipërm inxhinierik Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë: Kontratë pune e vlefshme gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

*** Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njehsuara me origjinalin.

Stafi i kërkuar në pikën 2.3.3 pika c, nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera, apo të deklaruar në procedura të shpallura fituese.

Nga Verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar elektronikisht nga Operatori Ekonomik BE - IS SH.P.K, rezulton se stafi i kërkuar në pikën 2.3.3 pika c, përkatësisht Ing Hidroteknik dhe Ing Ndërtimit janë të angazhuar në Kontratën me objekt: “Ndërtim Ujësjiellësi Cukë Bërdënesh Bashkia Sarandë”, të nënshkruar me Autoritetin Kontraktor Agjencia Kombëtare Ujësjiellës Kanalizimeve, gjë e cila bie ndesh me kriterin për kualifikim.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi i kualifikimit të tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Dokumentacioni i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik në këtë procedurë prokurimi, objekt vlerësimi nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit sqaron se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Operatori Ekonomik **BE - IS SH.P.K** me **NIPT K71412003A** nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Pika 2.3.3, germa d) Operatori ekonomik pjesëmarrës, në zbatim të Udhëzimit Nr.2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, duhet të përcaktojë me anë të një deklarate (nënshkruar nga Administratori i Shoqërisë), Drejtuesin Teknik të punimeve (inxhinier me eksperiencë) në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në licencën e shoqërise dhe të deklarojë se do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë vërtetësinë e deklaratës. Në rast deklarimi të rreme do të veprohet në përputhje me parashikimet e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” të ndryshuar.

*****Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetedeklarimin sipas Formularit të Vetëdeklarimit sipas Shtojcës Nr.8 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve**

provuese si më poshtë: Kontratë pune e vlefshme gjate gjithë kohes se zbatimit te punimeve objekt kontrate, Diplomë, Librezë pune dhe CV.

Nga Verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar elektronikisht nga Operatori Ekonomik Shoqëria “BE-IS” shpk, rezulton se stafi i kërkuar në pikën 2.3.3 pika d, rezulton se drejtuesi teknik i punimeve i përcaktuar nga administratori i shoqërisë Ergi është drejtues teknik i punimeve në Kontratën me objekt: “Ndërtim i Linjës së Jashtme të Furnizimit me ujë me vetërrjedhje për Ujësjiellësin Dropull + Lidhja e Burimit të Manxifes + Depo për fshatin Grapsh dhe Dervician”, të nënshkruar me Autoritetin Kontraktor, Agjencia Kombëtare Ujësjiellës Kanalizimeve, gjë e cila bie ndesh me kriterin për kualifikim.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi i kualifikimit i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Dokumentacioni i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik në këtë procedurë prokurimi, objekt vlerësimi nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit sqaron se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Operatori Ekonomik **BE - IS SH.P.K** me **NIPT K71412003A** nuk plotëson Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Pika 2.3.5, Makineri Pajisje:

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës të deklarojë vendndodhjen e mjeteve të kërkuara në procedurën e prokurimit publik si dhe te pranojë verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.

Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të paraqesë një deklaratë të nënshkruar nga Administratori, me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Nga Verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar elektronikisht nga Operatori Ekonomik Ergi rezulton se Makineritë e kërkuara në pikën 2.3.5, përkatësisht:

Nr.	Përshkrimi	Sasia
1.	<i>Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtes jo me pak se 20 ton</i>	<i>1 (nje) cope</i>
2.	<i>Kamionçina me kapacitet mbajtes deri në 3.5 ton</i>	<i>2 (dy) cope</i>
3.	<i>Rimorkiator per transportin e makinerive</i>	<i>1 (nje) cope</i>
4.	<i>Eskavator me goma</i>	<i>1 (nje) cope</i>
5.	<i>Fadrome me goma</i>	<i>1 (nje)cope</i>
6.	<i>Autobetoniere</i>	<i>1 (nje) cope</i>

Janë të angazhuara në Kontratën me objekt: “Ndërtim i Linjës së Jashtme të Furnizimit me ujë me vetërrjedhje për Ujësjiellësin Dropull + Lidhja e Burimit të Manxifes + Depo për fshatin Grapsh dhe Dervician”, të nënshkruar me Autoritetin Kontraktor, Agjencia Kombëtare Ujësjiellës Kanalizimeve, gjë e cila bie ndesh me kriterin për kualifikim, si dhe deklaratat e paraqitura nga OE me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruara nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Dokumentacioni i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik në këtë procedurë prokurimi, objekt vlerësimi nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit sqaron se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumenatcionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetej i skualifikuar.

Sa më lart, referuar nenit 92 paragrafi 3 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar me Ligjin Nr.16 datë 08.02.2024, ku parashikohet: “Autoriteti ose enti kontraktor në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji”, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave pranë Autoritetit Kontraktor **bëri s`kualifikimin e Operatorit Ekonomik BE - IS SH.P.K me NIPT K71412003A.**

6. Bashkimi i Operatorëve Ekonomik **Shoqëria CURRI me NIPT J67902718S** me adresë: Tirane, Njesia Administrative Nr.10, Rruga Kajo Karafili, Nd.2, H.4, Ap.3, 1001 & **Shoqëria XHENGO me NIPT J64103171M** me adresë: Don Gjon Buzuku , L.5,, Korce, Korce, me vlerë të ofruar 428,601,594.12 (katërqind e njëzet e tetë million e gjashtëqind e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e katër pike dymbëdhjetë) lek pa TVSH.

S`Kualifikohet

Arsyet:

Bashkimi i Operatorëve Ekonomik **Shoqëria CURRI me NIPT J67902718S & Shoqëria XHENGO me NIPT J64103171M**, në ofertën e dorëzuar në SPE rezulton se BOE ka ofertuar mbi fondin limit të parashikuar AK për realizimin e punimeve objekt prokurimi.

Referuar frymës së legjislacionit për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t`i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t`u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi. Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit. Për pasojë, Komisioni gjykon, se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në

dokumentet e tenderit, e rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme.

Dokumentacioni i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik në këtë procedurë prokurimi, objekt vlerësimi nuk është i rregullt dhe për shkak të mangësive që ka nuk plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe si i tillë konsiderohet i pavlefshëm.

Komisioni i Vlerësimit sqaron se, mosplotësimi qoftë edhe i një kriteri të vendosur nga ana e autoritetit kontraktor e bën ofertën e operatorit ekonomik të pavlefshme.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për shkak të ekonomicitetit procedural ka vlerësuar të panevojshëm vijimin e verifikimit të dokumenatcionit të operatorit ekonomik, duke qënë se përsëri statusi juridik i këtij operatori do të mbetet i skualifikuar.

7. Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [Ekonomik **Shoqëria 2 T** me **NIPT K01731001M**, Adresa: Tirane Tirane TIRANE Rruga Asim Vokshi, Nd. 14, H. 4, Ap. 5,], se oferta e paraqitur me vlerë totale prej 381,940,467.3 (treqind e tetëdhjetë e një million e nëntëqind e dyzet mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë pike tridhjetë) lekë pa TVSH] / totali i pikëve të marra [**249,45**] është identifikuar si ofertues i sukseshëm.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR